



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 31.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.07.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "DWH ALBANIA" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " DWH- ALBANIA" SH.P.K. e dt.27.07.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 25.07.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 25.07.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.27.07.2023, Operatori Ekonomik " DWH ALBANIA" SH.P.K ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me instrument GPS ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 31.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa për dijenin tuaj ri-vlerësimi e kthen procedurën në pikën "0", d.m.th. ri-shiqohet edhe njëherë të gjitha ofertat pavarësisht se a janë eliminuar, të pasuksesshme apo fituese.

Pretendimet e juaja janë të pabazuara sepse ju keni ofruar hapesire memorizuese te kontrollert te antenes GNSS, ekstrem me te ulet se sa kerkesa e AK. Si dhe Sistemi operativ I ofruar nuk perputhet me Windows 10.

Ju sipas broshurave te ofruara ne dosjen e tenderit, për import / export të të dhënave ka ofruar vetem DWG /DXF). Gjithashtu mungojnë edhe formatet tjera të të dhënave si: CSV, Shape File, TXT (nëse ekzistojnë atëherë edhe këto formate te argumentohen përmes screenshot-ave ne softuerin e instrumentit). Edhe për Stacion Total nuk i keni plotësuar kërkesat e lartpërmendura për specifikat e kërkuara nga Autoriteti kontraktues.

Edhe diçka të fundit, nuk e kuptojmë brengosjen tuaj për mos përzgjedhjen e " DWH KOSOVA" SH.P.K.!

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës